


# Indeksi i Çmimeve të Importit

## Tremujori I, 2024

**Tiranë, më 05 Qershor:** Indeksi i Çmimeve të Importit, në tremujorin e parë të vitit 2024, arriti 108,1 kundrejt vitit 2021 si periudha bazë. Krahasuar me tremujorin e parë 2023, indeksi i çmimeve të importit shënoi një ulje me 1,9 %, një vit më parë ky ndryshim ishte me rritje 1,2 %. Ndryshimi tremujor i indeksit të çmimeve të importit në tremujorin e parë 2024, krahasuar me tremujorin e katërt 2023 është -0,8 %.

Fig.1: Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Importit sipas tremujorëve



**Ndryshimi vjetor:** Çmimet e importit të produkteve në seksionin “Industri nxjerrëse” shënuan një ulje me 2,9 %, pasuar nga seksioni “Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar” me 2,5 %, “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” me 1,4 %. Gjithashtu, çmimet në seksionin “Industria përpunuese” me peshën më të madhe prej 93,5 % shënuan një ulje prej 1,8 %. Brenda këtij seksioni ulja më e madhe e çmimeve vërehet në produktet e aktivitetit “Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara” me 5,6 %, pasuar nga “Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi” me 5,0 %, “Prodhimi i produkteve të duhanit” me 4,1 %, “Përpunimi i tekstilëve” me 3,8 %, “Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës” me 3,2 %, “Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p.k.t” me 3,0 %. Nga ana tjetër çmimet në aktivitetin “Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve” shënuan rritje me 2,8 %, pasuar nga aktivitetet “Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit” me 1,4 %, “Prodhimi i pijeve” me 1,1 % dhe “Industri të tjera p.k.t” me 0,2 %.

**Ndryshimi Tremujor:** Krahasuar me tremujorin e katërt 2023, çmimet në seksionin “Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar” shënuan ulje me 1,8 %, pasuar nga seksionet “Industria nxjerrëse” me 0,8 % “Industria Përpunuese” me 0,7 %. Brenda seksionit “Industria përpunuese” ulja më e madhe e çmimeve vërehet në produktet e aktivitetit “Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës” me 2,5 %, pasuar nga “Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve, prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi” me 1,6 %, “Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara” me 1,3 %, “Konfeksionimi i veshjeve” me 1,2 %, etj.

Nga ana tjetër çmimet e seksionit “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” shënuan rritje me 1,2 %.

**Tab.1: Indeksi i Çmimeve të Importit**

2021=100

NVE Rev.2	Përshkrimi	Peshat	01-24	02-24	03-24	I-24
	<b>Gjithsej</b>	<b>100</b>	<b>108,2</b>	<b>108,1</b>	<b>108,0</b>	<b>108,1</b>
<b>B</b>	<b>Industria Nxjerrëse</b>	<b>0,2</b>	<b>111,3</b>	<b>111,5</b>	<b>111,6</b>	<b>111,5</b>
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,2	111,3	111,5	111,6	111,5
<b>C</b>	<b>Industria Përpunuese</b>	<b>93,5</b>	<b>106,3</b>	<b>106,3</b>	<b>106,3</b>	<b>106,3</b>
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	11,3	113,2	113,2	113,2	113,2
11	Prodhimi i pijeve	3,1	113,3	113,3	113,3	113,3
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	1,3	102,3	102,3	102,3	102,3
13	Përpunimi i tekstileve	4,4	104,6	104,6	104,5	104,6
14	Konfeksionimi i veshjeve	4,2	104,4	104,4	104,4	104,4
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	2,8	103,7	103,7	103,7	103,7
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	2,5	101,4	101,6	101,6	101,6
17	Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letre	2,3	106,1	106,0	106,3	106,1
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	0,0	110,6	110,6	110,6	110,6
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	9,8	107,4	107,6	107,6	107,5
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	7,6	105,3	105,1	105,1	105,2
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	6,3	100,1	100,1	100,1	100,1
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	4,0	99,0	99,0	99,0	99,0
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	3,6	111,6	111,6	111,6	111,6
24	Metalurgjia	8,6	109,9	109,9	109,9	109,9
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	3,5	108,1	108,1	108,1	108,1
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	3,8	106,4	106,4	106,4	106,4
27	Prodhimi i paisjeve elektrike	5,6	108,6	108,7	108,7	108,7
28	Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p.k.t	5,5	101,2	101,2	101,2	101,2
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	0,3	110,0	110,0	110,0	110,0
31	Prodhimi i mobiljeve	0,8	100,9	100,9	100,9	100,9
32	Industria të tjera p.k.t	2,0	105,0	105,0	105,0	105,0
<b>D</b>	<b>Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar</b>	<b>5,2</b>	<b>150,8</b>	<b>146,8</b>	<b>144,0</b>	<b>147,2</b>
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	5,2	150,8	146,8	144,0	147,2
<b>E</b>	<b>Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve</b>	<b>1,0</b>	<b>108,0</b>	<b>108,0</b>	<b>108,0</b>	<b>108,0</b>
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,0	108,0	108,0	108,0	108,0

Tab.2: Ndryshimet tremujore dhe vjetore të Indeksit të Çmimeve të Importit

		në %		
NVE	Përshkrimi	Peshat	I-24 / IV-23	I-24 / I-23
	<b>Gjithsej</b>	<b>100</b>	<b>-0,8</b>	<b>-1,9</b>
<b>B</b>	<b>Industri Nxjerrëse</b>	<b>0,2</b>	<b>-0,8</b>	<b>-2,9</b>
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,2	-0,8	-2,9
<b>C</b>	<b>Industria Përpunuese</b>	<b>93,5</b>	<b>-0,7</b>	<b>-1,8</b>
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	11,3	-0,9	-2,5
11	Prodhimi i pijeve	3,1	-1,1	1,1
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	1,3	-0,7	-4,1
13	Përpunimi i tekstileve	4,4	-1,1	-3,8
14	Konfeksionimi i veshjeve	4,2	-1,2	-2,7
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	2,8	-0,1	-0,7
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobilie; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	2,5	-1,6	-5,0
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre	2,3	-0,3	-1,1
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	0,0	-1,3	-5,6
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	9,8	-2,5	-1,4
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	7,6	0,5	-1,4
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	6,3	-0,7	-2,0
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	4,0	-1,0	-3,2
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	3,6	-0,5	-0,4
24	Metalurgjia	8,6	-1,1	-2,9
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	3,5	1,3	2,8
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	3,8	-0,2	-2,8
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	5,6	0,3	-0,2
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p.k.t	5,5	-0,9	-3,0
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	0,3	-0,2	1,4
31	Prodhimi i mobilie	0,8	-0,5	-1,8
32	Industri të tjera p.k.t	2,0	-0,1	0,2
<b>D</b>	<b>Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar</b>	<b>5,2</b>	<b>-1,8</b>	<b>-2,5</b>
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	5,2	-1,8	-2,5
<b>E</b>	<b>Fumizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbejeve</b>	<b>1,0</b>	<b>1,2</b>	<b>-1,4</b>
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbejeve; rikuperimi i materialeve	1,0	1,2	-1,4

# Metodologjia

**Indeksi i Çmimeve të Importit** duke filluar nga tremujori i parë 2024 do të llogaritet me bazën e re. Viti 2021 do të shërbejë si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (Viti 2021=100).

**Indeksi i Çmimeve të Importit** mat ecurinë e çmimeve të transaksioneve të produkteve industriale të importuara për tu shitur në tregun vendas.

## **INSTAT llogarit dhe publikon:**

Indeksin e Çmimeve të Importit

Ndryshimet tremujore dhe vjetore të indeksit

## **Fusha e mbulimit:**

Seksioni B - Industri Nxjerrëse

Seksioni C – Industri Përpunuese

Seksioni D - Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar

Seksioni E - Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit

## **Llogaritja e indeksit**

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE rev,2) në nivel 2-shifror.

## **Matësit e Indeksit**

**Ndryshimi vjetor** mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korrent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve vjetore në nivelet e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të çdo tremujori,

**Ndryshimi tremujor** mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korrent dhe tremujorit të mëparshëm.